



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 03/L-212 të Punës konkretisht Neni 8, bazuar në Rregulloren Nr. 01/2024 Për Kriteret dhe Procedurat e Punësimit në KMDK Sh.A., Rregullores Nr. 02/2025 për Organizimin e Brendshëm, Pagat, Benefitet dhe shtesat në KMDK Sh.A, bazuar në Vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv të KMDK Sh.A nr. 207/2026 të dt. 24.06.2026 me nr. të protokollit 02/1193 KMDK SH.A shpall këtë:

KONKURS PUBLIK PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Titulli: Ekspert për Projektim dhe Monitorim (1 pozitë);

Numri i Referencës: ZP/KJ-08-2026;

I raporton: Drejtorit të Departamentit për Planifikim dhe Zhvillim;

Niveli i pagës me koeficient 60: 1200.00€ Bruto (njëmijë e dyqind Euro) në muaj, subjekti i ndryshimit sipas vendimit të Bordit të Drejtorëve të KMDK-së;

Orët e Punës: 40 orë në javë, orari i plotë i punës në bazë të Ligjit të Punës;

Kohëzgjatja e kontratës: Me kohë të caktuar (1 vit) me mundësi vazhdimi, puna provuese zgjatë deri në gjashtë (6) muaj;

Vendi i punës: KMDK – Sh.A., Prishtinë.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Harton projekt-dokumentacionin teknik në përputhje me kërkesat dhe standardet përkatëse;
- Përgatit skica, plane, specifikime teknike dhe dokumente të tenderimit për projekte infrastrukturore apo zhvillimore;
- Siguron që projektet të jenë në përputhje me politikat institucionale, ligjet dhe standardet e aplikueshme (kombëtare dhe ndërkombëtare);
- Monitoron zbatimin teknik të projekteve, përfshirë inspektimet në terren dhe përgatitjen e raporteve të progresit;
- Bashkëpunon me palët e interesit (konsulentë, kontraktorë, institucione publike dhe komunitetin lokal) për të siguruar zbatim të suksesshëm të projekteve;

- Identifikon devijimet dhe ndërmerr masa korigjuese për të siguruar përputhje me projektin dhe afatet;
- Merr pjesë në procesin e vlerësimit të ofertave dhe monitoron përmbushjen e kontratave nga palët e treta;
- Përgatit raporte të rregullta mbi ecurinë dhe rezultatet e projekteve;
- Siguron dokumentimin korrekt dhe arkivimin e të gjitha materialeve të projektit.

Përvoja/Edukimi:

- Diplomë universitare në inxhinieri ndërtimi, arkitekturë, inxhinieri mjedisore, ose fusha të ngjashme teknike;
- Përvojë profesionale prej së paku 3 vite në fushën e projektimit teknik dhe/ose monitorimit të projekteve të infrastrukturës, mjedisit apo zhvillimit lokal;
- Eksperiencë në përgatitjen e dokumentacionit teknik (projekte, plane, specifikime teknike) dhe/ose mbikëqyrje në fazën e implementimit të projekteve;
- Pjesëmarrje në zbatim projektesh të financuara nga donatorë ndërkombëtarë, institucionet publike apo organizata të shoqërisë civile (është përparësi);
- Aftësi në përgatitjen e raporteve të progresit teknik dhe raporteve narrative për projektet e zbatuara.

Shkathtësitë tjera:

- Aftësi të avancuara në përdorimin e softuerëve për projektim dhe vizatime teknike (si AutoCAD, Civil 3D, ose softuerë të ngjashëm);
- Aftësi të shkëlqyera komunikuese në të shkruar dhe të folur, me stil të qartë, të saktë dhe profesional;
- Aftësi të forta në organizim, menaxhim kohe dhe përmbushje të afateve;
- Saktësi dhe vëmendje ndaj detajeve gjatë përpunimit të dokumenteve teknike dhe administrative;
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe brenda ekipeve ndërdisiplinare, me nivel të lartë të iniciativës dhe përgjegjësisë;
- Diskrecion dhe aftësi për ruajtjen e konfidencialitetit, sidomos në menaxhimin e informacionit teknik apo institucional;
- Fleksibilitet dhe aftësi për të përballuar dinamika pune dhe detyra të paparashikuara në terren apo zyre;
- Njohuri të mira të gjuhës angleze (e preferuar);
- Patentë shoferi, kategoria B (e preferueshme për inspektime në terren);
- Njohuri mbi funksionimin e institucioneve publike dhe proceset e prokurimit publik apo të menaxhimit të mbeturinave dhe mjedisit janë avantazh shtesë.

Procedura e konkurrimit:

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyret e Burimeve Njerëzore të KMDK SH.A apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën: <https://kmdk-ks.org/>.

Dokumentacionin mund të paraqitet në mënyrë:

- elektronike,
- nëpërmjet adresës elektronike burimetnjerzore@kmdk-ks.org,
- përmes postës ose
- në kopje fizike në zyret e Burimeve Njerëzore në adresën: Rruga “Gazmend Zajmi”, nr.41, Prishtinë.

Aplikacioni i dërguar nëpërmjet adresës elektronike konsiderohet i pranuar nëse pranoni konfirmimin nga adresa për pranimin e aplikimit. Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe adresën elektronike.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Formulari zyrtar i aplikimit (i plotësuar dhe i nënshkruar);
- Kopje e letërnjoftimit ose pasaportës valide;
- CV e detajuar me përvojë pune;
- Diploma dhe dëshmi të kualifikimeve (diplomat e marra jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHTI);
- Dëshmi për përvojën e punës (kontrata ose vërtetime, dhe pasqyrë e kontributeve pensionale); dhe
- Certifikata se kandidati nuk është nën hetime dhe nuk është i dënuar (jo më të vjetra se data e publikimit të konkursit);
- Letërmotivimi

Kandidatët janë plotësisht përgjegjës për dorëzimin e dokumentacionit të saktë, të plotë dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në konkurs. Mosdorëzimi i cilitdo dokument të kërkuar, dorëzimi i dokumentacionit jo të plotë apo të pasaktë, sjell diskualifikim nga procedura e rekrutimit.

KMDK Sh.A. nuk mban përgjegjësi për mungesën, pasaktësinë apo paplotësinë e dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët. Në rast nevoje për sqarime administrative lidhur me dokumentacionin e dorëzuar, KMDK Sh.A. mund të kërkojë informata apo dokumente plotësuese vetëm brenda afatit të aplikimit.

Ju lutem sigurohuni që dëshmia për përvojën profesionale (minimum 3 vite) të përfshijë kontratën ose vërtetimin e punës, të shoqëruar me pasqyrën e kontributeve pensionale (Trustin).

Mënyrat e vlerësimit dhe kriteret e poentimit

Vlerësimi i aplikimeve të konkursit publik në KMDK përmban gjithsej njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë për qind (50%) të pikëve nga të gjitha fazat e konkursit publik. Kriteret e poentimit: jetëpërshkrimi (CV) e kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë, testimi me shkrim deri në gjashtëdhjetë (60) pikë dhe intervistimit deri në tridhjetë (30) pikë.

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tre (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pa kompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

Afati për aplikim është deri me datën **24.07.2026 në orën 16:00.**

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni me Zyrën e Burimeve Njerëzore të KMDK në numrin e telefonit 038 600–552 apo në adresën elektronike burimetnjerzore@kmdk-ks.org.